



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale
Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu
Department of Health and Social Welfare

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštë Upravu

-III- Nr. i prot Q187 Mö 16.07.2019
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORT I PUNËS

JANAR- QERSHOR 2019

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Raporti gjashtëmujor i punës për vitin 2019 i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Rahovec, paraqet punën, zhvillimin dhe të arriturat kryesore të drejtorisë dhe stafit të saj. Përmes këtij raporti, DSHMS, paraqet detyrat dhe të arriturat drejt realizimit të planit të punës si dhe detyrat e tjera që dalin sipas detyrës zyrtare për të ofruar shërbime sa më cilësore për qytetarët e komunës së Rahovecit.

DSHMS-ja ka bashkëpunuar dhe mbështetur organizatat joqeveritare të cilat kanë qenë të gatshme për bashkëpunim, ku kemi pasur suksese në të gjitha fushat duke ndihmuar në realizimin e qëllimit të përbashkët para qytetarëve të komunës tonë.

Caktimi i prioriteteve të punës dhe përcjelljen e nevojave sociale, shërbimeve shëndetësore ka qenë punë e përditshme e DSHMS-së dhe stafit të saj.

Aktivitetet e DSHPS-së

- Konsultimet dhe takimet e rregullta me stafin, Drejtorin e QPS-së dhe të QKMF-së në Rahovec;
- Përpilimi i raporteve javore, mujore të punës për vitin 2019, dhe krijimi nevojës për raportim të vazhdueshëm;
- Angazhimi rreth përmirësimit të kushteve për punë të nëpunësve dhe stafit në përgjithësi në kuadër të DSHMS-së;
- Shqyrimi dhe përgjigja me kohë ndaj kërkesave të ndryshme të qytetarëve, si dhe të atyre për ndihmë momentale-financiare;
- Ka vazduar ofrimi i shërbimeve në QMF-të në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, me dy ndërrime, të cilat tanimë janë të përhershme;
- Shënim i përvjetorit të dhurimit të gjakut në Dejnë dhe Ratkoc, poashtu ka vazduar dhurimi i gjakut edhe në Vrajakë, Dobidol dhe Krushë të Madhe, Kramovik, Sopniq etj;
- Në muajin mars 2019 është nënshkruar marëveshja me CARITAS KOSOVA për ofrimin e shërbimeve mjekësore - programi "Home Care- Kujdesi Shtëpiak" për persona në nevojë, persona në regjim shtrati, ku janë angazhuar 48 punëtorë shëndetësor, dhe në bashkëpunim me DKA-në kemi angazhuar edhe 5 pedagogë dhe psikologë. Për dallim nga herat e tjera, kjo marrëveshje ka shkuar me procedurë të prokurimit, pas vërejtjeve të dhëna nga Auditori Gjeneral, pasi që më heret kjo marrëveshje është nënshkruar vetëm me negocim;

RAPORT I PUNËS JANAR – QERSHOR 2019

- Shërbimet në shëndetësi janë avancuar - kemi pranuar mjekë, stomatologë të ri, poashtu janë avancuar edhe shërbimet në fizioterapeuti, që më herët nuk kemi pasur shërbime të fizioterapeutike. Tash kemi fizioterapeut permanent në QKMF, e në të ardhmen shpresojmë që shërbimet e tillë të ofrojmë edhe në dy QMF-të, apo qendra më të mëdha, si në Ratkoc dhe Krushë të Madhe;
 - Kemi avancuar me shërbime stomatologjike, kemi punësuar dy stomatologë të ri. Tash kemi stomatologë permanent në dy QMF-të, në Drenoc, dhe Fortesë, presim shumë shpejtë të angazhojmë stomatologë edhe në dy QMF të tjera, në Opterushë dhe Çifllak;
 - Kemi subvencionuar OJQ-të, që merren me veprimtaritë sociale, si shoqatat: "Hareja", "Hendikos" dhe shumë shoqata të tjera;
 - Presim shumë shpejtë që të hapet Reparti i Hemodializës në QKMF, gjë që ishte dhe është një sfidë e cila po tejkalohet. Reparti do të hapet në pjesën e dytë të vitit 2019 dhe pacientët me dializë do të kenë mundësi që shërbimet t'i marrin në repartin e Hemodializës në QKMF- Rahovec;
 - Shërbimet diagnostike janë avancuar, kemi të angazhuar specialistin e biokimisë në laborator, poashtu, në radiologji kemi të angazhuar edhe specialistin e Radiologjisë (Radiolog).

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Ndërtimi i QKMF-së, faza e dytë dhe përfundimtare, projekti deri më tani është perfunduar 70%, besojmë që me ndihmën e qeverisë së Kosovës, brenda vitit do të përfundojmë objektin e QKMF-së dhe Emergjencës.
 - Dezinsektimi, Dezinfektim dhe Derratizimi- DDD - jemi në fazën e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik.
 - Ndërtimi i QMF-së në Çifllak, është në procedurë prokurimi.
 - Dixhitalizimi i Rentgenit - i paraparë në pjesën e dytë të vitit 2019.
 - Renovimi i ndërtesës së QP-së – i përfunduar si projekt.

Me respekt!



Drejtor i DSHPS-së